



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Mbledhja nr. 41
Prishtinë, më 28.6.2016, ora 11,00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Murat Hoxha, Sërgjan Popoviq, Emilija Rexhepi, Shaip Muja dhe Salih Salihu.
Mungoi: Haxhi Shala.

Të ftuar dhe pjesëmarrës tjerë, sipas listës së nënshkrimeve.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi, **Salih Salihu**, nënkryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 8.6.2016;
3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Performancën Energjetike;
4. Të ndryshme.

Kryesuesi **Salih Salihu**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa vërejtje si dhe propozimi për një pikë të re nga **Adem Salihaj**, për formimin e grupeve punuese për dy ligje, të cilat duhet të mbikëqyren nga Komisioni sipas planit të punës, ushqimin dhe kadastrën.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 8.6.2016;

Procesverbali i datës 8.6.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Performancën Energjetike në ndërtesa;

Kryesuesi për këtë pikë të rendit të ditës, propozoi që të shtyhet për një javë, për shkak të informimit më të mirë të Komisionit, por **Shaip Muja** shprehu mendimin që nuk ka nevojë të shtyhet ngase është në të mirë të standardizimit të amvisërisë, sa i përket energjisë dhe prodhimit energjetik, prandaj ky projekt mund të dërgohet në leximin e parë, ku më tutje do të ketë mundësi për intervenime deri në leximin e dytë, përndryshe mbetet që kjo të bëhet pas pushimeve dhe do të zvarritet pa nevojë.

Adem Salihaj tha se mund ta shohim pak se a i plotëson kushtet për leximin e parë, kurse **Murat Hoxha**, po ashtu, propozoi që të shtyhet për mbledhjen e radhës dhe vërejtje se fjala e parë e Projektligjit (performanca) nuk është adekuate. Çka nënkuptohet me këtë standard të banimit dhe me çfarë konkretisht do të merret ky Projektligj, theksoi **Sërgjan Popoviq**.

Salih Salihu nuk e kundërshtoi kompetencën e këtij Komisioni, por shprehu dyshime në profesionalizmin e këtij Komisioni lidhur me këtë Projektligj dhe sugjeroi që pas leximit të parë, të shfrytëzohet fondi i komisionit për ekspertët përkatës.

Komisioni vendosi që ky Projektligj të shqyrtohet në parim në mbledhjen e radhës.

4. Formimi i dy grupeve punuese për mbikëqyrje të Ligjit për Ushqimin dhe Ligjit për Kadastrën;

Kryesuesi hapi diskutimin rreth formimit të dy grupeve punuese, sipas planit të punës për mbikëqyrjen e ligjeve përkatëse. Pas diskutimeve polemizuese, kryesuesi konstatoi anëtarët e dy grupeve :

Grupi punues për mbikëqyrjen e Ligjit për Kadastër :

- 1. Murat Hoxha, kryesues**
- 2. Salih Salihu, anëtar,**
- 3. Duda Balje, anëtare**
- 4. Shaip Muja, anëtar**

Grupi punues për mbikëqyrjen e Ligjit për ushqimin :

- 1. Adem Salihaj, kryesues**
- 2. Salih Salihu, anëtar, dhe**

3. Emilija Rexhepi, anëtare

Edhe pse të dy grupet u votuan nga Komisioni, vazhduan polemikat në mes **Adem Salihaj** dhe **Shaip Mujës** rreth interesit për mbikëqyrjen e këtyre dy ligjeve, ndërsa në pyetjen e z. Muja “pse ti veten e shpalle kryesues”, z. A. Salihaj tha “sepse ti nuk ke muajt me i kry ende punët e tua në grupet e tua të punës”, kurse në konstatimin e z. Muja “a e dini që po përgatitet Projektligji për AUV”, z. Salihaj tha “po e dina por ajo nuk ka të bëjë me problematikën e ushqimit por agjencisë”, etj. Gjithashtu Adem Salihaj theksoi se “me ty nuk punoj sepse ti më pengon gjatë punës”...

5. Të ndryshme.

Kryesuesi në këtë pikë hapi çështjet si vijon :

- Përkundër faktit që shkresa e Komisionit rreth hartimit të Ligjit nga Qeveria për shpronësime është proceduar për mbledhje plenare, kjo shkresë do të shfuqizohet deri në mbledhjen e radhës së Komisionit, kur kryesuesi i GP **Murat Hoxha** do të korrigjojë të njëjtën, pastaj do të procedohet më tutje;
- **Iniciativa për vizitën e Komisionit tek Komisioni homolog në Parlamentin e Shqipërisë** është kryer edhe gojarisht nga deputeti **Murat Hoxha**, në lokalet e Ambasadës së Shqipërisë në Prishtinë dhe pritet një përgjigje deri më 10 korrik, mirëpo, Komisioni sugjeroi që fillimisht kryetarja e Komisionit këtë iniciativë ta konfirmojë në kryesinë e Kuvendit, e pastaj të hartohet agjenda. Duhet të kemi parasysh, tha **Emilija Rexhepi**, ngase edhe në Shqipëri ministrët nuk kanë bashkëpunim të mirë me parlamentin, andaj duhet të kujdesemi kënd duhet të vizitojmë;
- **Një ankesë për grant** e dërguar në Komision, sipas sugjerimit të kryetares është analizuar nga z. Murat Hoxha, i cili deri në mbledhjen e radhës mbetet të informojë më në detaje komisionin (bëhet fjalë për Liridon Berishën, i cili për shkak të mosrealizimit të grantit të premtuar, është dashur të hyjë në borxhe), gjithashtu edhe **Salih Salihu** shprehu dilemat rreth aplikuesve që nuk i kanë kompletuar aplikacionet, duke cekur shembullin konkret, mirëpo, **Adem Salihaj** rikujtoi se ministri para komisionit ka kërkuar argumente, andaj sugjeroi mos të shkohet më tutje pa argumente, ndërsa **Shaip Muja** u përgjigj “ti faktikisht po bënë denoncim ndaj vëllait të Hashimit, prandaj ti duhesh të paraqitesh si dëshmitarë e jo si iniciues”...
- Duhet të kërkohet nga Qeveria përgjigje pse nuk ka realizuar rekomandimet e këtij komisioni rreth Inspektoratit bujqësor dhe pse nuk po zbatohen ato,
- **Emilija Rexhepi** kërkoi përgjigje me shkrim nga stafi i komisionit dhe pyeti pse nuk ka zbatuar urdhrin e saj në cilësinë e kryesueses së GP për Projektligjin për Zhurmën, për të ftuar bashkësitë fetare në grupin punues, sepse ky Projektligj nuk bënë të fshihet por të punohet në mënyrë transparente. Ajo gjithashtu bëri pyetje për Qeverinë, pse kriteret për pakica, sa i përket granteve nuk ndryshohen por prapë përsëriten, kurse **Sërgjan Popoviq** shtoi se për komunitete duhet të formohet një fond i veçantë, jo pse janë komunitete por për shkak të forcimit të konkurrimit me fermerë tjerë, ndërkaq lidhur me tabelën e propozuar në grupin

- për zhurmën, tha se ndoshta duhet të shkojë edhe në nivelin lokal për mendim dhe si të veprohet,
- **Adem Salihaj** lidhur me ndërhyrjen e kryesueses për Projektligjin për zhurmën tha : “unë u befasova me e-mailin e kryesueses së GP-së, ngase qëndrimi i GP-së nuk ka qenë të ftohen bashkësitë fetare dhe nuk pajtohem nëse nuk ka vendim GP-ja, ne si deputetë dhe kryesuesja personalisht mund t’i ftojë, por jo në emër të GP-së ngase nuk kemi marr qëndrim dhe pas muajit të Ramazanit mund të vlerësojmë prapë, por kjo është”.
 - Pasi që Kryesuesja kërkoi përgjigje me shkrim, **stafi** ka përgjigje të ngjashme sikurse deputeti Adem Salihaj, gjithashtu stafi ka komunikuar me kryetaren e Komisionit, e cila ka mbështetur mendimin e z. Adem Salihaj dhe ka urdhëruar mos të ftohen bashkësitë fetare ngase nuk është qëndrim i GP-së. Pos kësaj, ky Projektligj me nenin përkatës sqaron se nuk ka të bëjë me institucionet fetare,
 - **Adem Salihaj** njoftoi shkurtimisht Komisionin për vizitën e tij në Shqipëri, në një seminar ku organizata botërore EITTI ka bërë nismën shumë të mirë rreth industrisë nxjerrëse që është me interes edhe për Kosovën, por pasi nuk ka pasur transparencë në këtë drejtim është organizuar ky seminar me temën të cilën Kosova duhet ta përkrahë pa hamendje,
 - **Duda Balje, kryetare,** e cila për shkak të angazhimeve mbërriti në fund të mbledhjes, ndryshoi vendimin e Komisionit për mbledhjen e radhës, për të martën, ngase këtë ditë, më 5 korrik është festa e Bajramit, prandaj kjo mbledhje u caktua të mbahet më 8 korrik dhe kërkoi pjesëmarrje në grupin punues për Kadastrën, propozim ky i cili nuk u kundërshtua nga deputetët e pranishëm.

Mbledhja përfundoi në orën 12:25.

E përgatiti stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Duda Balje